



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 5 pika d të Ligjit NR. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 30 e datës 15 qershor 2008, nenit 14 të Rregullores (QRK) Nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____, të miratojë këtë :

PROPOZIM

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS AD.HOC PËR PËRZGJEDHJEN E DREJTORËVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE EDUKATIVO ARSIMORE TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

Me këtë Vendim, formohet Komisioni Ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve/eve në institucionet publike edukativo-arsimore në Komunën e Lipjanit për konkurset për zgjedhjen e drejtorëve sipas kërkesës së Drejtorit të DKA-Lipjan nr.01-020/04-4075 të datës 27.01.2026, në përbërje si vijon:

1. Brahim Duriqi, DKA, Kryesues
2. Teuta Berisha, eksperte e arsimit, anëtare dhe
3. _____ **Caktohet nga MASHT**, anëtar

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati i Komisionit përzgjedhës

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit përzgjedhës janë përzgjedhja e drejtorit/es dhe zëvendësdrejtorit/es së IEAAP, duke shikuar dokumentacionin e të gjithë kandidatëve që kanë aplikuar, të intervistojë dhe vlerësoj me pikë kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe kriteret sipas procedurave të Rregullores (QRK) Nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (ieaa) të arsimit parauniversitar.

2. Mandati i anëtarëve është i përkohshëm ad.hoc dhe vlenë vetëm për konkursset për zgjedhjen e drejtorëve në:

Drejtor/e në këto shkolla :

- Çerdhja në Lipjan
- SHFMU "Zenel Hajdini" në Gadime
- SHFMU "Ernest Koliqi" në Babush i Muhaxherëve
- SHFMU "Vëllezërit Domaneku" në Topliqan
- SHFMU "Dy Dëshmorët" në Dobrajë e Madhe

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për të propozuar këtë Vendim është e përcaktuar me dispozitat e nenit 58 shkronja h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 40 shkronja h.) e Statutit të Komunës së Lipjanit.

Baza juridike dhe obligimi ligjor për të miratuar këtë Vendim është e përcaktuar, nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 5 pika d të Ligjit NR. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës nenit 14 Rregullores (QRK) Nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 020/04-4462
Lipjan, më 28.01.2026

KRYETARI I KOMUNES

Imri Ahmeti

